



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.375/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj-kryesuese, Skender Çoçaj dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtruara nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Arjant Topanica, të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat e parashtruara nga kandidati për Kuvendin e Komunës së Podujevës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Arjant Topanica, ZL.Anr.375/2025, ZL.Anr.376/2025, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat e parashtruara nga Arjant Topanica kandidat për kuvend komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e subjektit politik LDK, në ankesën ZL.Anr.375/2025 pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave në QKN në Podujevë, ashtu që pas përfundimit të numërimit të votave është konstatuar se një numër i konsiderueshëm rreth 8 vota nuk figurojnë në vendvotimin përkatës 1814/02 dhe 1814/03 në Sfeçël. Tutje ka theksuar se këto vota janë numëruar dhe dëshmuar të jenë evidente natën e Zgjedhjeve nga vëzhguesit përkatës. Ka theksuar se në vendvotimin 1814/01 ka pasur 53 vota, i njëjti numër ishte paraqitur edhe pas numërimit në QKN, vendvotimi 1814/02 ka pasur 46 vota, pas numërimit në QKN i figurojnë 39 vota, në vendvotimin 1814/03 ka pasur 101 vota, ndërsa pas numërimit në QKN i figurojnë 100 vota. Pavarësisht se këto vota janë verifikuar natën e zgjedhjeve nga ekipet përkatës në vendvotime dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga KQZ gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e pashpjegueshme, duke ngrehur dyshime se ka pasur mos regjistrim, humbje ose trajtim të pasaktë të këtyre fletëvotimeve. Ka kërkuar nga PZAP të urdhëroj verifikimin e plotë të procesit të pranimi, ruajtjes dhe numërimit të votave nga qendrat e votimit për

Komunën e Podujevës, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të mos pasqyrimit të rreth 8 votave. Të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor, duke përfshirë rihapjen dhe rivlerësimin e kutive përkatëse, nëse kjo është e nevojshme.

Si prova, parashtruesi i ankesës në ankesë ka bashkangjitur numrat e telefonit të dëshmitarëve që sipas tij mund ta vërtetojnë ankesën e tij.

Në ankesën ZL.Anr.376/2025 të datës 04.11.2025 parashtruesi i ankesës pretendon se ka pasur parregullsi në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjatë procesit të pranimit të fletëvotimeve përmes postës ku një numër i konsiderueshëm prej rreth 30 fletëvotimeve me vota nuk figurojnë në kutitë përkatëse, vota këto të dërguara nga familjare të ngushtë. Tutje ka theksuar se pavarësisht se këto vota janë dërguar brenda afateve ligjore dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga KQZ, gjatë numërimit të tyre është vërejtur mungesa e tyre e pashpjegueshme. Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP të urdhëroj verifikimin e plotë të procesit të pranimit, ruajtjes dhe numërimit të votave me postë për Komunën e Podujevës, me qëllim të identifikimit të shkaqeve të mospasqyrimit të rreth 30 votave, rihapjen dhe rivlerësimin e kutive përkatës, dhe të sigurohet që të gjitha votat e dërguara në mënyrë të rregullt të numërohen dhe të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, për ankesën ZL.Anr.375/2025, sqaron se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese, theksohet se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 par.1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilitdo Vendvotim, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, ju njofton se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.14/2024, ku ekipet kanë numërimin kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Pretendimet e palës lidhur me shkeljet e supozuara, janë të pasafatshme, sepse lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, ankesat dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë(48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Pra, procesi i numërimit në QKN-Podujevë ka përfunduar me datë 15.10.2025, kurse pala ankesën e ka parashtruar me datë 04.11.2025. Në kuptim të nenit 117 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkangjitur asnjë provë relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij. Pra nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova tjera që mbështesin pretendimet e tij. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN

në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, për ankesën ZL.Anr.375/2025, sqaron se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime, Ne faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkangjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime), Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr.17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17 Fletëvotimet qe janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit .në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vertëtohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe poashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.375/2025, ZL.Anr.376/2025, të datës 04.11.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.375/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- **Ankesat janë të pabazuara.**

Paneli pas shqyrtimit të ankesave dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoi se pretendimet e kandidati për asamble komunale në Komunën e Podujevës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Arjant Topanica, se ka pasur parregullsi në qendra të votimit të cekura në ankesat, *përkatësisht se që pas përfundimit të numërimit të votave është konstatuar se një numër i konsiderueshëm rreth 8 vota nuk figurojnë në vendvotimin përkatës 1814/02 dhe 1814/03 ne Sfeçël* dhe pretendimet se “*pas përfundimit të procesit të numërimit të votave të ardhura me postë, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i votave- rreth 30 fletëvotime me vota- nuk figurojnë në kutitë përkatëse- se ka pasur mospranim, mos regjistrim, humbje ose trajtim të pasakte të këtyre fletëvotimeve*”, për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë nuk ka arritur që t’i vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesat e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesave prova konkrete dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat. Ndërsa pretendime e lart cituara tani për tani mbeten vetëm ne suaza te dyshimit nga se nuk është arritur te provohet me prova bindëse për parregullsitë e theksuara si në ankesë.

Sa i përket pretendimeve te palës ankuese që mbështetet në deklarinimin e disa personave – respektivisht ne deklarinimet e votuesve, te identifikuar me emër dhe mbiemër. Paneli vlerëson se qëndron fakti se është e drejtë e votuesit që pas votimit të deklarohet lirshëm lidhur me votën e tij, apo që të interesohet për votën e tij, por mënyra e te provuarit respektivisht deshmite e ofruara nuk i përmbushin as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për hapjen e kutive të votimit.

Po ashtu paneli vlerëson se është e pa kontestuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 te LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë te garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit te votuesve në parim cenon fshehtësinë votës.

Neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se “*Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka te drejte te pengoje ndonjë qytetar per te votuar, te detyroje atë ne një mënyrë, te mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës se tij/saj të zbuloj votën e tij/saj ose arsyet per mos votim*”

Mirepo do te duhej cekur se lidhur me deklarata e votuesve dhe fshehtësisë se votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: “*deklaratat e votuesve te cilët pretendojnë se kane votuar një kandidat te caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë forme se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit*”.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesat e paraqitura, parashtruesi e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur mungesë të votave,

Andaj Paneli vlerësoj nuk është provuar me asnjë provë se ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.375/2025, datë 05.11.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.